

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7821  
E premte, 28 qershor 2024  
Çmimi 0.50 €

## Diplomojnë kadetët e rinj të FSK-së



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KUPCHAN: KURTI DUHET TË BISEDOJË, NUK KA ZGJIDHJE ME ULTIMATUME



Ish-drejtori i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së thotë se kryeministri i Kosovës nuk është dashur të refuzojë të bisedojë me presidentin e Serbisë në

takimin e thirrur më 26 qershor nga BE-ja. "Unë mendoj se nuk është në dobi të Kurtit të refuzojë të ulet në tryezën e bisedimeve sepse, nën një, një gjë e tillë e portretizon Kosovën

si palë më kokëfortë dhe, nën dy, mosmarrëveshjet afatgjatë nuk zgjidhen kurrë kur njëra palë jep ultimatume ose refuzon të bisedojë", ka theksuar Kupchan

## O'BRIEN: MOSZBATIMI I MARRËVESHJEVE TË KALUARA, MUNDËSI E HUMBUR PËR PALËT



## AGK-ja: PROJEKTLIGJI PËR KPM-në ËSHTË DRAFTUAR NGA QEVERIA NË PROCEDURË JOTRANSPARENTË



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## AKTUALE



### HYN NË FUQI LIGJI I RI GJERMAN QË LEHTËSON RRUGËN PËR DYSHTETËSI

F. 2

### KURTI PARAQITI TRI KUSHTE PËR ANGAZHIM NË PROCESIN E DIALOGUT

F. 3

### ODA EKONOMIKE AMERIKANE: TË SHQETËSUAR NGA SULMET VERBALE NDAJ GJYKATËS KUSHTETUESE

F. 7

## EKONOMI



### MBI 5 000 KONSUMATORË KANË PËRDITËSUAR TË DHËNAT NË KESCO

F. 8

### NGA 1 KORRIKU PAGA MESATARE E MËSUESVE NË SHQIPËRI 950 EURO

F. 8

## SPORT



### DUKA: TË GJITHË JEMI KRENARË ME KOMBËTAREN, TIFOZËT MERITOJNË NOTËN 10

F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Hap i guximshëm, administrata Biden po e konsideron vendosjen e kontraktorëve ushtarakë amerikanë në Ukrainë

WASHINGTON, 27 QERSHOR - Katër zyrtarë amerikanë thanë për CNN se qeveria do ta ndihmojë ushtrinë ukrainase t'i mirëmbajë dhe të riparojë sistemet e armëve që vetë ShBA-ja i ka ofruar. Ky do të ishte një tjetër ndryshim i rëndësishëm në politikën e jashtme të administratës Biden, pasi ShBA-ja po kërkon mënyra për t'i dhënë ushtrisë së Ukrainës një dorë kundër Rusisë. Megjithatë, nuk ka ende asnjë vendim të firmosur nga presidenti Joe Biden, raporton CNN.

Nuk kemi marrë asnjë vendim dhe çdo diskutim për këtë është i parakohshëm. "Por, presidenti është absolutisht i vendosur se nuk do të dërgojë trupa amerikane në Ukrainë", tha një zyrtar i administratës. Pasi të miratohet, ndryshimi ka të ngjarë të hyjë në fuqi këtë vit,



thanë zyrtarët dhe do të lejojë Pentagonin të sigurojë kontrata për kompanitë amerikane për punë brenda Ukrainës për herë të parë që nga pushtimi i Rusisë më 2022.

Zyrtarët thanë se shpresojnë se do ta përshpejtojë mirëmbajtjen dhe riparimet e sistemeve të armëve që përdoren nga ushtria ukrainase. Gjatë dy viteve të fundit Bideni

ka këmbëngulur që të gjithë amerikanët, veçanërisht trupat amerikane, të qëndrojnë larg vijave të frontit ukrainas. Shtëpia e Bardhë ka qenë e vendosur ta kufizojë rrezikun për amerikanët dhe perceptimin, veçanërisht nga Rusia, se ushtria amerikane është e përfshirë në luftime atje. Si rezultat, pajisjet ushtarake të ofruara nga ShBA-ja që kanë pësuar dëme të konsiderueshme në luftime duhet të transportohen jashtë vendit në Poloni, Rumania ose vende të tjera të NATO-s për riparime, një proces që kërkon kohë. Trupat amerikane janë gjithashtu të disponueshme për t'i ndihmuar ukrainasit me mirëmbajtje dhe logjistikë rutinë, por vetëm përmes video-chatit. Por, zyrtarët e administratës filluan t'i rishqyrtojnë këto

kufizime gjatë muajve të fundit, pasi Rusia vazhdoi të fitonte në fushën e betejës dhe fondet e ShBA-së për Ukrainën ngecën në Kongres. Lejimi i kontraktorëve amerikanë me përvojë dhe të financuar nga qeveria amerikane në Ukrainë do të thotë se ata do të jenë në gjendje të ndihmojnë në rregullimin e pajisjeve të dëmtuara dhe me vlerë të lartë shumë më shpejt.

Diskutimet pasojnë një sërë vendimesh që ShBA-ja ka marrë muajt e fundit për ta ndihmuar Ukrainën t'i mposhtë rusët. Në fund të majit Bideni i dha Ukrainës lejen për t'i goditur objektivat brenda Rusisë, pranë kufirit me qytetin ukrainas Kharkiv, me armë amerikane, një kërkesë që ShBA-ja e kishte mohuar vazhdimisht në të kaluarën.

## Hyn në fuqi ligji i ri gjerman që lehtëson rrugën për dyshtetësi

BERLIN, 27 QERSHOR - Ligji i ri për shtetësinë në Gjermani ka hyrë në fuqi të enjten. Ky ligj lehtëson rrugën për marrjen e pasaportës gjermane, përfshirë mbajtjen e dyshtetësisë.

Ligji i ri, i cili u propozua nga koalicioni qeveritar trepartiak i qendrës së majtë i Gjermanisë, ua mundëson njerëzve ta marrin shtetësinë gjermane pa e humbur shtetësinë e vendit të lindjes.

Njerëzit tani mund të aplikojnë për shtetësi gjermane pasi të kenë jetuar pesë vjet në Gjermani, nëse i plotësojnë të gjitha kushtet. Në të kaluarën, kusht ishte tetë vjet banim në

Gjermani.

Fëmijët e lindur në Gjermani nga prindër të huaj do ta fitojnë shtetësinë gjermane nëse njëri prej prindërve ka qenë banor i ligjshëm në Gjermani për pesë vjet.

Njerëzit që dëshmojnë "arritje të veçanta në integrim" përmes paraqitjeve veçanërisht të mira në shkollë, punë apo në angazhim në shoqëri, mund ta fitojnë pasaportën gjermane pas vetëm tri vjetëve qëndrimi.

Një çështje e rëndësishme e ligjit të ri është se njerëzit që e marrin shtetësinë gjermane nuk detyrohet të heqin dorë nga shtetësia e vendlindjes së tyre.

Në të kaluarën, kjo ka qenë e mundur vetëm për banorët e vendeve të tjera të BE-së në Gjermani.

Njësoj, edhe gjermanët që duan të bëhen qytetarë të një vendi tjetër nuk kanë nevojë për autorizim të veçantë nga autoritetet gjermane. Në të kaluarën, pa autorizim, ata do ta kishin humbur shtetësinë gjermane në momentin që do ta kishin marrë shtetësinë e një vendi tjetër. "Shumë njerëz e kanë pritur këtë me dekada", tha komisionarja për Integrim e Gjermanisë, Reem Albaliradovan, anëtare e partisë së Social Demokratëve (SPD).



## Finlanda, shteti i parë që do t'i vaksinonjë njerëzit kundër gripit të shpezëve



HELSINKI, 27 QERSHOR - Finlanda planifikon të bëjë vaksinimin e njerëzve kundër gripit të shpezëve nga java e ardhshme. Fillimisht kjo vaksinë do t'u ofrohet disa punëtorëve që punojnë me kafshët, thanë autoritetet shëndetësore.

Shteti nordik ka blerë vakcina për 10 000 persona. Ato jepen përmes dy dozave dhe vaksinat janë blerë në kuadër të blerjes së përbashkët të Bashkimit Evropian për 40 milionë doza për 15 shtete, nga prodhuesi CSL Seqirus.

Komisioni Evropian tha se Finlanda do të jetë shteti i parë që do të ofrojë vakcina të tilla për njerëzit. "Vaksinat do t'u ofrohen personave mbi 18 vjeç që janë në rrezik më të madh që të preken nga gripit i shpezëve për shkak të punës së tyre dhe rrethanave të tjera", tha Instituti finlandez për Shëndet dhe Mirëqenie. Vitet e fundit gripit i shpezëve apo varianti H5N1 ka shkaktuar vdekjen e qindra miliona shpezëve në mbarë botën në vitet e fundit dhe, po ashtu, gjithnjë e më shumë po

përhapet te gjitarët, përfshirë lopët në Shtetet e Bashkuara, por në disa raste po prek edhe njerëzit.

Autoritetet thanë se Finlanda nuk ka regjistruar asnjë rast me këtë grip te njerëzit. Megjithatë, shteti dëshiron ta nisë vaksinimin për shkak të rrezikut të përhapjes së sëmundjes në ferma. Vitin e kaluar, për shkak të përhapjes së gripit të shpezëve në ferma, Finlanda asgjësoi 485 000 kafshë, në mënyrë që virusi të mos përhapej te njerëzit.



# Kurti paraqiti tri kushte për angazhim në procesin e dialogut



**BRUKSEL, 27 QERSHOR** - Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka bërë me dije se në Bruksel nuk është mbajtur takim trepalësh, duke theksuar se Kosova nuk ishte e gatshme për një takim të tillë. Ai tha se gjatë takimeve dypalëshe Kurti paraqiti tri kushte për angazhimin e mëtejshëm në procesin e normalizimit të raporteve me Serbinë. “E para, formalizimi i Marrëveshjes Bazë përmes nënshkrimit nga krerët respektivë të shteteve. E dyta, tërheqja e letrës zyrtare e dorëzuar në BE nga ish-kryeministrja serbe, Ana Bërnabiq, më 13 dhjetor 2023. Dhe e treta, dorëzimi i

Millan Radoičiqit dhe grupit të tij paramilitar terrorist tek autoritetet gjyqësore të Kosovës”, tha Borrelli në një konferencë për medie. Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve, që është arritur më 27 shkurt të vitit 2023 në Bruksel dhe Aneksi për zbatimin e saj që është arritur më 18 mars 2023 në Ohër, nuk i kanë nënshkrimet e Kurtit dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, sepse udhëheqësi serb ka refuzuar një gjë të tillë. Asnjëra palë, deri më tash, nuk ka bërë ndonjë lëvizje drejt zbatimit të ndonjë elementi të kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër

të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t’i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Gjatë konferencës për medie, Borrelli tha se Serbia nuk ishte e gatshme që plotësisht t’i pranonte kushtet e vendosura nga Kurti, përderisa “presidenti Vuçiq la të kuptohet se është i gatshëm të eksplorojë mundësi sa i përket letrës së ish-kryeministres dhe formalizimit të Marrëveshjes [në rrugën drejt normalizimit të raporteve], në linjë me praktikat e

shkuara të dialogut, në mënyrë që të zhblokohet zbatimi i marrëveshjes. Gjatë takimeve të ndara midis Borrellit dhe të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, me Kurtin dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, sipas Borrellit, palët paraqitën qëndrimet e tyre se si procesi duhet të ecë përpara. “Si zakonisht, diskutimet ishin të vështira dhe në fund nuk pati takim trepalësh. Kosova nuk ishte e gatshme për një takim të tillë, Serbia ishte”, tha ai. Para takimit, BE-ja ka paraqitur një propozim të ri për planin e zbatimit të Marrëveshjes në

rrugën drejt normalizimit të raporteve, që palët arritën vitin e kaluar.

Borrelli tha se, “fatkeqësisht, kushtëzimi i zbatimit nuk lejoi që diskutimet të përqendroheshin në veprime konkrete të zbatimit nga palët sot”. Ai tha se palët vazhdojnë të kenë qëndrime të ndryshme se si duhet të zbatohet kjo marrëveshje, por edhe se si duhet të vazhdojë procesi i normalizimit. “Tani u takon palëve të tregojnë konstruktivitet dhe të mundësojnë që procesi të lëvizë përpara. Kjo është në interesin e tyre dhe është në interesin e aspiratave të tyre për integrim evropian”, tha Borrelli. Borrelli, po ashtu, konfirmoi se Lajçaku do t’i presë në takim kryenegociatorët e Kosovës dhe Serbisë javën e ardhshme për t’i vazhduar diskutimet për planin e zbatimit të Marrëveshjes, por edhe për çështje të tjera të dialogut. Pas takimeve në Bruksel, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se ka kërkuar nga ndërmjetësit evropianë “garanci për mirëbesim dhe vullnet të mirë të cilat mundësojnë zbatimin e marrëveshjeve”.

Deri më tani Kosova ka refuzuar ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, për të cilin palët janë pajtuar më 2013 pavarësisht prej thirrjeve të vazhdueshme nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara.

Kurti dhe Vuçiqi nuk kanë zhvilluar takim të përbashkët në Bruksel që nga shtatori i vitit të kaluar, takim që u mbajt disa ditë para se të ndodhte sulmi i armatosur në Banjskë të Zveçanit. Sulmi, që u krye nga një grup i armatosur serbësh, la të vrarë një polic të Kosovës. Gjatë këmbimit të zjarrit, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkyetari i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit. I pyetur se pse nuk pati takim trepalësh, Kurti tha se që nga takimi i fundit “ka ndodhur shumëçka”, duke përmendur edhe sulmin në Banjskë.

## Diplomojnë kadetët e rinj të FSK-së

**PRISHTINË, 27 QERSHOR** - Në Kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë kanë diplomuar 16 kadetët e rinj të gjeneratës 2024 të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në ceremoni, përveç familjarëve, kanë marrë pjesë udhëheqës të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se kjo ditë është ditë krenarie dhe rezultat i përkushtimit shpirtëror dhe gatishmërisë për ta dhënë jetën për atdhe. “Ëndrrën e gjithë atyre që kanë pasur sot po e realizoni.

Nuk kam si ta fsheh krenarinë që kam. Kjo ndjenjë krenarie është rezultat i përkushtimit tuaj shpirtëror, gatishmërisë që keni për të dhënë jetën për atdhe. Të zgjohesh në mëngjes me këtë mision në zemër është me të vërtetë fisnike”, u shpreh ai. Maqedonci shtoi se pjesëtarët e FSK-së në vazhdimësi po tregojnë profesionalizëm dhe se ata po luftojnë vetëm për paqe ashtu si komandanti legjendar i Kosovës, Adem Jashari. “Është e vështirë, por është gjëja më e rëndësishme

në jetë t’i mësoni teknikat për luftim. Ju tani keni atë për t’u udhëhequr, përgatitjen fizike dhe emocionale, njohjen dhe aftësinë pa marrë parasysh situatën që gjendeni. Si ofruet të sigurisë dhe paqes janë ushtarakët tanë që krahe për krahe po ushtrojnë për ta mbrojtur atdheun. Ju pjesëtarët e FSK-së në vazhdimësi po tregoni profesionalizëm, partnerët tanë njohin qëndrimet tona, luftojmë vetëm për paqe ashtu si komandanti legjendar i Kosovës, Adem Jashari”, ka thënë ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci.







## Kupchan: Kurti duhet të bisedojë, nuk ka zgjidhje me ultimatume

Ish-drejtori i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së thotë se kryeministri i Kosovës nuk është dashur të refuzojë të bisedojë me presidentin e Serbisë në takimin e thirrur më 26 qershor nga BE-ja. “Unë mendoj se nuk është në dobi të Kurtit të refuzojë të ulet në tryezën e bisedimeve sepse, nën një, një gjë e tillë e portretizon Kosovën si palë më kokëfortë dhe, nën dy, mosmarrëveshjet afatgjatë nuk zgjidhen kurrë kur njëra palë jep ultimatume ose refuzon të bisedojë”, ka theksuar Kupchan

**PRISHTINË, 27 QERSHOR** - Charles Kupchan, ish-drejtor i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, thotë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk është dashur të refuzojë të bisedojë me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në takimin e thirrur më 26 qershor nga Bashkimi Evropian. Një gjë e tillë, sipas tij, “nuk shkon në dobi të Kurtit” “...sepse, nën një, Kosovën e portretizon si palë më kokëfortë dhe, nën dy, mosmarrëveshjet afatgjatë nuk

zgjidhen kurrë me ultimatume”, thotë Kupchan për Radion Evropa e Lirë. Shefi i politikës së Jashtme të BE-së, Josep Borrell, tha të mërkurën se Kurti e kushtëzoi vazhdimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me tri kërkesa: nënshkrimin e Marrëveshjes për rrugën e normalizimit të marrëdhënieve, tërheqjen e letrës me të cilën Serbia refuzoi zyrtarisht ta zbatojë marrëveshjen me Kosovën dhe dorëzimin në Kosovë të Millan

Radoiçiqit dhe grupit të tij, të dyshuar për sulmin e armatosur në Banjskë.

Borrelli tha se Vuçiqi nuk ishte i gatshëm t'i pranonte plotësisht kushtet e Kosovës.

Kupchan, tani profesor në Universitetin Georgetown, thotë se udhëheqësit e dy vendeve, herët a vonë, do të duhet të bëjnë “kompromise të vështira” dhe shpjegon se cilat janë ato.

*Pavarësisht prej përpjekjeve, Bashkimi Evropian nuk arriti t'i takonte bashkë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, tha se Kurti nxori disa kushte që Vuçiqi nuk i pranoi. A mund ta konsiderojmë këtë situatë si një bllokim?*

**Charles Kupchan:** Ky raund negociatash është sigurisht një bllokim. Fakti që bisedimet vazhdojnë, është një shenjë e mirë, por sigurisht se janë bërë jashtëzakonisht të vështira. Ka pasur shumë pak përparim që nga marrëveshja verbale [për

normalizimin e marrëdhënieve], që është bërë e njohur si Marrëveshja e Ohrit. Unë mendoj se nuk është në dobi të Kurtit të refuzojë të ulet në tryezën e bisedimeve sepse, nën një, një gjë e tillë e portretizon Kosovën si palë më kokëfortë dhe, nën dy, mosmarrëveshjet afatgjatë nuk zgjidhen kurrë kur njëra palë jep ultimatume ose refuzon të bisedojë. Palët duhet të ulen ballë për ballë dhe t'i zgjidhin çështjet në tryezë. Mendoj se do të ishte më mirë sikur Kurti të kishte biseduar me Vuçiqin dhe t'i kishte nxjerrë në tryezë shqetësimet e tij. Por, të nxjerrësh parakushte dhe të largohesh nga tavolina, sepse ato parakushte nuk janë plotësuar, nuk më duket qëndrim konstruktiv.

*Si i vlerësoni parakushtet e tij?*

**Charles Kupchan:** Mendoj se dy prej tyre janë të arsyeshme - një duhet të shqyrtohet. E arsyeshme është kërkesa [për dorëzimin e] Radoiçiqit, i cili ka pranuar se ka marrë pjesë në gjakderdhjen në Banjskë. Qoftë

autoriteti ligjor i Kosovës ai që vepron, apo autoriteti ligjor i Serbisë, ai është një individ që duhet të silltet para drejtësisë.

Kërkesa e dytë e arsyeshme ka të bëjë me letrën [e ish-kryeministres serbe, Ana Bërnabiq]. Mendoj se ajo letër është provokuese, në mënyrë të panevojshme, sepse Marrëveshja e Ohrit nuk specifikon njohjen, nuk specifikon se Serbia duhet ta pranojë Kosovën si shtet të pavarur, por fokusohet në normalizim. Në e dimë se normalizimi është hap drejt njohjes përfundimtare, por nuk është produktive për Serbinë që të nxjerrë një deklaratë të tillë bardh e zi. E sa i përket këmbënguljes së Kurtit që Vuçiqi ta nënshkruajë marrëveshjen, unë mendoj se ky është një argument më i dobët. Sepse, sipas mendimit tim, Vuçiqi me të drejtë beson se Kosova duhet ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe përpara se ta formalizojë marrëveshjen.

# O'Brien: Moszbatimi i marrëveshjeve të kaluara, mundësi e humbur për palët

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Ndhimëssekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien, ka thënë se Kosova dhe Serbia janë duke i "humbur vërtet" mundësitë e tyre duke mos i zbatuar marrëveshjet e arritura deri tani në dialogun e Brukselit, pasi të mërkurën dështoi të mbahej një takim i paralajmëruar trepalësh i liderëve të të dyja vendeve me shefin e diplomacisë së BE-së. "Takimet e sotme të Josep Borrellit me presidentin serb Aleksandër Vuçiq dhe kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, tregojnë se si palët duhet të ripërkushtohen për t'i luftuar problemet dhe për t'i ndjekur mundësitë brenda dialogut të lehtësuar nga BE-ja", shkroi O'Brien në "X". ShBA-ja, që mbështet dialogun e

Brukselit, vazhdimisht u kërkon palëve t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e dialogut. Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, konfirmoi se të mërkurën në Bruksel nuk u mbajt takim trepalësh me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, duke theksuar se Kosova nuk ishte e gatshme për një takim të tillë. Ai tha se gjatë takimeve dypalëshe Kurti paraqiti tri kushte për angazhimin e mëtejshëm në procesin e normalizimit të raporteve me Serbinë. Kushtet e Kurtit ishin formalizimi i Marrëveshjes Bazë përmes nënshkrimit nga krerët përkatës të dyja shteteve, tërheqja e letrës zyrtare të dorëzuar në BE nga ish-

kryeministrja serbe Ana Bërnabiq më 13 dhjetor 2023 si dhe dorëzimi i Millan Radoiçiqit dhe grupit të tij paramilitar "terrorist" tek autoritetet gjyqësore të Kosovës, tha Borrelli në një konferencë për medie të mërkurën. Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve, që u arrit më 27 shkurt të vitit 2023 në Bruksel dhe Aneksi për zbatimin e saj më 18 mars 2023 në Ohër, nuk janë nënshkruar nga Kurti dhe Vuçiqi, sepse udhëheqësi serb nuk ka pranuar ta bëjë këtë, me gjithë këmbëngulësinë e liderit të Kosovës. Asnjëra palë, deri më tash, nuk ka bërë ndonjë lëvizje drejt zbatimit të ndonjë elementi të kësaj

marrëveshjeje. Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Gjatë konferencës për medie Borrelli tha se Serbia nuk ishte e gatshme që plotësisht t'i pranonte kushtet e vendosura nga Kurti. Gjatë takimeve të ndara midis Borrellit dhe të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, me Kurtin dhe Vuçiqin, sipas Borrellit, palët paraqitën qëndrimet e tyre se si

procesi duhet të ecë përpara. Pas takimeve në Bruksel, Kurti tha se ka kërkuar nga ndërmjetësit evropianë "garanci për mirëbesim dhe vullnet të mirë të cilat mundësojnë zbatimin e marrëveshjeve". "Vetëm nënshkrimi i marrëveshjes sjell sigurinë ligjore dhe juridike në njërin anë, dhe anulon shkeljet e mëhershme", tha Kurti. Por, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, deklaroi për mediet në Bruksel se Kurti "nuk ka dashur apo nuk ka guxuar - pyeteni atë - të më takoj dhe të bisedojmë". Sipas presidentit serb, Kurti dëshiron që Serbia ta njohë Kosovën dhe "tani ka dalë me disa kërkesa të tjera, por në thelb është një njohje de jure".



Por, kanë kaluar nëntë muaj nga sulmi në Banjskë dhe Radoiçiqi është ende i lirë. Kush duhet të mbahet përgjegjës për këtë?

**Charles Kupchan:** Marrë parasysh se Radoiçiqi e ka pranuar fajësinë, në radhë të parë, Qeveria e Serbisë, gjykatat e Serbisë e kanë për detyrë të veprojnë. Deri më tani ato nuk kanë arritur ta mbajnë përgjegjës. Dhe, mendoj se Kurti ka të drejtë kur thotë se kjo është e papranueshme.

A ka ndonjë rrezik që Kosova të përballlet me ndonjë masë të re ndëshkuese, sepse Borrelli tha qartazi se Kosova nuk ishte e gatshme për dialog?

**Charles Kupchan:** Në të kaluarën e afërt, edhe Shtetet e Bashkuara, edhe BE-ja kanë mbajtur një qëndrim shumë më të ashpër ndaj Kosovës. Kjo për mua është e kuptueshme, sepse Kurti ka

ndërmarrë hapa provokues si për targat e makinave apo vendosjen e kryetarëve shqiptarë [në komunat me shumicë serbe në veri]. Unë nuk mendoj se kjo ka qenë një strategji produktive. Deri në vitet e fundit, mendoj se Shtetet e Bashkuara dhe evropianët e kanë parë më shumë Serbinë si problem dhe, për pasojë, trysnia është dashur të bëhet mbi Beogradin. Ka qenë Qeveria e Serbisë ajo që ka refuzuar të bëjë gjëra, por tani ekziston perceptimi se Prishtina refuzon dhe se Prishtina mban një pjesë të përgjegjësisë për paralizën. Nuk mendoj se kjo është në interesin e Kosovës.

Por, të paktën, sa iu përket targave të makinave, Kurti mund të thotë se ka pasur sukses, sepse në veri të Kosovës nuk qarkullojnë më makina me targa ilegale serbe...  
**Charles Kupchan:** Nëse kjo

arritje vjen në kurriz të Kosovës, të marrëdhënieve të saj me mbështetësit kryesorë në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara, të normalizimit të marrëdhënieve me Beogradin, nuk jam i sigurt se ia vlen.

Atëherë, cila është rrugëdalja?

**Charles Kupchan:** Të ndiqet rruga e normalizimit. Mendoj se Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja kanë sjellë energji dhe vendosmëri të përtërirë sa i përket kësaj çështjeje. Nuk mendoj se do t'i lënë Kurtin dhe Vuçiqin të qetë. Mendoj se do të bëjnë presion mbi të dy. Dhe, herët a vonë, do ta arrijmë vijën e finishit. Çështja është se kur Kurti dhe Vuçiqi - ose kushdo që vjen pas tyre, nëse nuk ndodh gjatë mandatit të tyre - do ta shohin politikisht të favorshme për të bërë kompromise të vështira.

Dhe ato kompromise të vështira janë?

**Charles Kupchan:** Për Kosovën - të pajtohet që t'u sigurojë serbëve që jetojnë në Kosovë një nivel të autonomisë, me të cilën gjë shumë kosovarë mund të mos jenë rehat. Për Serbinë - ta pranojë realitetin se e ka humbur Kosovën përgjithmonë dhe se, në fund të ditës, Serbia do të jetë më mirë. Por, siç e thashë, këto janë vendime të vështira dhe të dhimbshme që duhet t'i marrin udhëheqësit politikë.

Marrë parasysh se kjo mund të ketë qenë përpjekja e fundit e Borrellit për të ndërmjetësuar një takim në mes të Kurtit dhe Vuçiqit, pasi mandati i tij është drejt fundit, si do ta vlerësonit përkushtimin e Borrellit gjatë pesë vjetëve të fundit?

**Charles Kupchan:** Borrelli meriton nota të larta si përfaqësues i lartë. Mendoj se ka

bërë një punë të shkëlqyer në një pozitë që është e vështirë. Sepse shtetet anëtare [të BE-së], në njëfarë mënyre, nuk janë rehat me një ministër të jashtëm evropian të profilit të lartë, pasi kanë frikë se kjo shkon në kurriz të ministrave të tyre të jashtëm. Kështu që, personi në këtë pozitë ka një rrugë të vështirë për të ndjekur. Dhe, unë mendoj se Borrelli ia ka dalë mirë.

Cilat janë pritjet tuaja nga udhëheqja e re e BE-së në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi?

**Charles Kupchan:** Nuk parashikoj ndonjë ndryshim të konsiderueshëm të kursit apo humbje të entuziazmit.

Strategjia e deritashme do të funksionojë?

**Charles Kupchan:** Dikur, po. Pyetja është: a do të jemi unë dhe ju gjallë kur të funksionojë?!



## Një ditë pas vërshimeve, Kurti vizitoi Dragashin

**DRAGASH, 27 QERSHOR** - Kryeministri Albin Kurti ka vizituar të enjten komunën e Dragashit, e cila dje është përballur me vërshime të ujit të shkaktuara nga reshjet e mëdha të shiut.

Me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, në takimin e zhvilluar me kryetarin e komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini,

kryeministri Kurti i falënderoi institucionet lokale për angazhimin e tyre dhe ofroi ndihmën e vet dhe të institucioneve qendrore për tejkalimin e rimëkëmbjen nga dëmet e shkaktuara, për të cilat do të ketë vlerësim adekuat nga komisioni përkatës. “Qeveria do të jetë pranë jush dhe pranë qytetarëve”, u shpreh ai.

Kryetari Xheladini e njoftoi

kryeministrin mbi situatën në terren dhe për dëmtimet në infrastrukturë, për të cilat tha se ka nevojë për ndërhyrje urgjente dhe e falënderoi atë për vizitën dhe ministrin Krasniqi për bashkëpunimin dhe komunikimin e rregullt. Më pas i vizituan zonat e prekura nga vërshimet e djeshme të shkaktuara nga reshjet e shiut.



## Kastrati mban takimin e parë publik me qytetarë për vitin 2024

**MALISHEVË, 27 QERSHOR** - Në kuadër të përbushjes së detyrimeve ligjore dhe transparencës, kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka mbajtur të enjten takimin e parë publik me qytetarët për vitin 2024. Në këtë takim ai prezantoi punën dhe angazhimet e qeverisë komunale në gjashtëmujorin e parë të vitit. Kryetari Kastrati në mënyrë kronologjike ua paraqiti qytetarëve projektet dhe angazhimet kryesore të komunës, përkatësisht të qeverisë komunale të cilën e drejton. Ai filloi me projektin



madhor “Malisheva Urbane” dhe vazhdoi me prezantimin e projekteve në fushat e arsimit, infrastrukturës, shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe bujqësisë. Gjithashtu, ai përmendi lirimim e hapësirës publike si një nga të arriturat e mëdha gjatë mandatit të tij në drejtimin e komunës së Malishevës. Kastrati shprehu mirënjohjen e tij ndaj qytetarëve për mirëkuptimin dhe mbështetjen për realizimin e projekteve komunale. Ai diskutoi sfidat me të cilat përballet komuna, duke përfshirë çështjen aktuale të furnizimit me energji elektrike.

Kryetari informoi se për shkak të investimeve në rrjetin energjetik, Malisheva po përballet me ndërprerje të gjata të energjisë. Megjithatë, ai njoftoi se ka arritur një marrëveshje me KEDS-in për t'i zvogëluar ndërprerjet gjatë verës, për ta lehtësuar korrijen dhe grumbullimin e grurit, përballimin e temperaturave të larta dhe mbërritjen e mërgimtarëve. Kryetari Kastrati iu përgjigj pyetjeve të qytetarëve, të cilat kryesisht lidheshin me nevojën për investime në infrastrukturë dhe çështje të tjera të rëndësishme për komunitetin.

## Kuvendi i komunës së Mitrovicës miraton kornizën afatmesme buxhetore për vitet 2025-2027

**MITROVICË, 27 QERSHOR** - Është mbajtur mbledhja e 32-të e rregullt e Kuvendit të komunës së Mitrovicës, të cilën e ka udhëhequr kryesuesja e Kuvendit Komunal, Vesa Broja. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, Bedri Hamza, asamblistët dhe drejtorët e drejtorive komunale. Kjo mbledhje nisi me një minutë heshtje në nderim dhe kujtim të mitrovicasit Qëndrim Ferati, djalit të zyrarit të komunës së Mitrovicës, inspektorit Bedri Ferati, i cili ka humbur jetën para disa ditësh si pasojë e një aksidenti të rëndë. Më pas kryesuesja Broja propozoi rendin e ditës për miratim, me

ç'rast këshilltarët komunalë me shumicë votash aprovuan rendin e ditës për këtë seancë. Në këtë mbledhje asamblistët e Kuvendit Komunal shqyrtuan, miratuan dhe mbështetën materialet e parapara me rendin e propozuar të ditës. Në vazhdim asamblistët aprovuan me shumicë votash kornizën afatmesme buxhetore 2025-2027; Propozim-vendimin për caktimin e qirasë për shfrytëzuesit e Parkut Industrial dhe Parkut Teknologjik në Mitrovicë; Propozim-vendimin për miratim të nismës për bashkëpunim ndërkomunal; Strategjinë për kulturë 2024-2027. Ndërkaq pikat e rendit të ditës për dhënien e titullit “Qytetar Nderi”



për Bernd Baumgarten dhe raporti i Komisionit Komunal të

Aksionarëve të N. P. “Tregu” për vitin 2023 janë shtyrë për

mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal.

## Rama merr pjesë në festën e madhe britanike të çajit të organizuar në Shkodër



**PRISHTINË, 27 QERSHOR** - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se ka marrë pjesë në festën e madhe britanike të çajit të organizuar në hotel “Tradita” në Shkodër nga kryetari i bashkisë, Benet Beci. “I thamë lamtumirë dhe falënderuam ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, shtz. Alastair King-Smith. Në një atmosferë brilante në qytetin e bukur dhe historik të Shkodrës,

bashkë me Kristale Rama diskutuam me ambasadorin King-Smith mbi bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve tona dhe përpjekjet për ta mbështetur rininë shqiptare, veçanërisht në zonat ku sfidat janë më të mëdha. Falënderuam, gjithashtu, për investimet e shumta që Mbretëria e Bashkuar ka bërë në Shkodër dhe në Shqipëri, duke ndihmuar në zhvillimin ekonomik dhe social të

rajonit”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Ai ka thënë se Mbretëria e Bashkuar ka dhënë mbështetje të madhe për Prishtinën dhe shtetin e Kosovës, duke forcuar lidhjet mes dy vendeve dhe duke promovuar paqen dhe stabilitetin në rajon. “I urojmë ambasadorit Alistair çdo sukses dhe e falënderojmë për shërbimin e tij të jashtëzakonshëm”, ka shkruar Rama.



## AGK-ja: Projektligji për KPM-në është draftuar nga qeveria në procedurë jotransparente

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Kryetari i Bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Xhemajl Rexha dhe këshilltarja ligjore, Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, Flutura Kusari, i kanë bërë thirrje Lëvizjes Vetëvendosje të mos votohet Projektligji për Komisionin e Pavarur për Media i cili ishte në rend dite në seancën e së enjtes të Kuvendit. "E ftojmë Lëvizjen Vetëvendosje që të mos e votojë këtë projektligj që shkel standardet e Këshillit të Evropës dhe kërkojmë që draftimi i tij të bëhet përmes një grupi të gjerë punues që përfshin ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe industrisë së medias. Ne shprehim gatishmërinë tonë ta ndihmojmë procesin e draftimit me synimin për një ligj për media që është në pajtim të plotë me standardet evropiane. Kosova ka pësuar rënie të paprecedentë dhe alarmante në indeksin e lirisë së medie në Reportereve pa Kufij, duke rënë për 19 vende në krahasim me vitin

paraprak. Miratimi i këtij ligji nuk do të kontribuojë në përmirësimin e lirisë së medie në vend", është thënë në deklarinim të tyre për medie.

Sipas tyre, Projektligji për Komisionin e Pavarur për Media është draftuar nga qeveria në procedurë jotransparente, pa përfshirjen e shoqërisë civile dhe të industrisë së medie dhe është aprovuar në qeveri në kohë festash të fundvitit. "Komisioni për Media i Kuvendit të Kosovës e ka trajtuar projektligjin me shpejtësi të madhe, pa përfshirje të shoqërisë civile, ndërsa opozita përgjithësisht ka qenë e painteresuar në procesin e draftimit dhe nuk ka ofruar alternativa të tjera nga ajo çfarë ka propozuar pushteti. Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë kanë gjetur që projektligji devijon nga standardet evropiane dhe kanë ofruar rekomandime për ta përmirësuar projektligjin. Rekomandimet nuk janë shqyrtuar apo trajtuar me seriozitet nga ana e Komisionit për Media dhe 83 % e tyre janë injoruar", ka thënë ata. Ata kanë theksuar se Projektligji



për KPM nuk është i qartë, krijon pasiguri juridike dhe nuk respekton parimin e proporcionalitetit. "Përmes tij, ndër të tjera, pritet të kapet

politikisht Komisioni i Pavarur për Media dhe mediet online do t'i nënshtrohen një rregullimi kaotik që nuk do të funksionojë në praktikë. Nëse aprovohet

projektligji, pluralizmit medial si një arritje dhe vlerë që e dallon Kosovën nga rajoni do të rrezikohet seriozisht", kanë theksuar Rexha dhe Kusari.

## Oda Ekonomike Amerikane: Të shqetësuar nga sulmet verbale ndaj Gjykatës Kushtetuese

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e thellë lidhur me sulmet e fundit verbale të liderëve të qeverisë ndaj institucioneve të pavarura gjyqësore, veçanërisht Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

OEAQ-u thekson se në shoqëritë demokratike ndarja e pushteteve është thelbësore. "Prandaj, institucionet e pavarura duhet të veprojnë pa ndërhyrje me qëllim të ruajtjes së integritetit të procesit demokratik. Deklaratat që cenojnë këto institucione janë të papranueshme, meqë shkelin parimin e ndarjes së pushteteve



dhe gërryejnë vlerat demokratike, për ndërtimin e të cilave Kosova ka punuar shumë. Është detyrë e të gjitha palëve të interesit dhe zyrtarëve politikë ta respektojnë

kornizën kushtetuese dhe ligjore të shtetit. Kjo përfshin jo vetëm kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e përgjegjësisë të tyre, por edhe ruajtjen e

pavarësisë së institucioneve të tjera. Formulimi i politikave, ndërtimi i konsensusit, hartimi i legjislacionit dhe rishikimi i akteve ligjore duhet të bëhen brenda kufijve të respektimit të pavarësisë së gjyqësorit", thuhet në reagim.

Oda Amerikane u bënë jehonë thirrjeve të misioneve diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare në të kaluarën për respektim të vendimeve gjyqësore, ndërsa thekson se ky respekt është kritik për të ardhmen demokratike të Kosovës. Ekzekutivi dhe të gjithë hisedarët politikë duhet ta njohin dhe respektojnë pavarësinë e të gjitha shtyllave të pushtetit, duke përfshirë gjyqësorin, median, shoqërinë civile, sektorin privat

dhe organet e pavarura rregullative. "Mbajtja e këtyre parimeve siguron llogaridhënie dhe transparencë, të cilat janë jetike për ndërtimin e besimit publik, rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve, përmirësimin e qeverisjes, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive dhe parandalimin e abuzimit me pushtetin. Prandaj, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë u kërkon udhëheqësve të shtetit t'i respektojnë vendimet gjyqësore dhe të përmbahen nga deklaratat që ndërhyjnë në punën e gjyqësorit. Institucionet e Kosovës kanë obligim të vazhdueshëm ta respektojnë sundimin e ligjit në të gjitha rrethanat, duke shmangur në këtë mënyrë ushtrimin arbitrar të pushtetit", thuhet tutje në reagim.

## Drejtori i Policisë viziton veriun, informohet mbi gjendjen e sigurisë

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, së bashku me zëvendës drejtorin e përgjithshëm Fehmi Hoti dhe atasheun Kimberly Riffe, DOJ-ICITAP pranë Ambasadës Amerikane vizituan veriun e vendit, gjegjësisht njësitet policore të policisë kufitare dhe ata të rendit publik në Jarinjë, Leposaviq, Bërnjak dhe në Banjskë, ku më 24 shtator 2023

u pat vlarë rreshteri Afrim Bunjaku. Drejtori Hoxha bisedoi me zyrtarët policorë të cilët ishin në kryerje të detyrave, duke u interesuar për gjendjen e përgjithshme, sfidat, vështirësitë dhe realizimin e detyrave dhe aktiviteteve policore në atë pjesë të vendit. Ndër të tjera, në takimet me zyrtarët policorë, drejtori i përgëzoi ata për punën dhe angazhimin në kryerje të detyrave, duke ofruar siguri

për të gjithë, pa dallime etnike dhe sundim të rendit dhe ligjit. Po ashtu, delegacioni nga Prishtina u prit edhe nga zëvendës drejtori i Drejtorisë Rajonale Policore Mitrovicë Veri, Veton Elshani, i cili i ka njoftuar eprorët e PK-së rreth gjendjes së përgjithshme të sigurisë në veri të vendit. Drejtori i përgjithshëm i policisë, me bashkëpunëtorë, vizitoi dhe vuri kurorë me lule në vendin e rënies së heroit të Kosovës, Enver Zymberi.





## Nga 1 korriku paga mesatare e mësuesve në Shqipëri 950 euro

TIRANË, 27 QERSHOR - Prej datës 1 korrik, me vendim qeverie, do të hyjë në fuqi rritja e pagave për 30 mijë punonjësit e sistemit arsimor në Shqipëri. Kryeministri Edi Rama në

rrjetet sociale ka thënë se kjo u arrit falë një rruge të mundimshme reformash dhe rimëkëmbjes tërësore. Kreu i qeverisë shprehet se “e morëm në dorë copë e çikë dhe e çuam pagën mesatare

të mësuesve në 950 euro në muaj”. “Me kënaqësinë që falë një rruge të mundimshme reformash e rimëkëmbjeje tërësore të këtij vendi që e morëm në dorë copë e çikë, e çuam

pagën mesatare të mësuesve në 950 euro në muaj, si edhe me bindjen se më e mira është ende përpara, ju uroj një ditë të mbarë”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



## Një delegacion i deputetëve gjermanë viziton Kosovën, njoftohet për zhvillimet ekonomike

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), bashkë me Ambasadën Gjermane në Prishtinë, kanë mirëpritur në takim delegacionin e deputetëve nga radhët e CSU të rajonit të Bavarisë të udhëhequr nga Karl Freller.

Vizita e tyre në Kosovë filloi në OEGJK, ku delegacioni u mirëprit nga Nora Hasani, drejtoreshë ekzekutive e OEGJK-së bashkë me zëvendësambasadorin gjerman Matthias Conrad. “Deputetët gjermanë u informuan mbi zhvillimet ekonomike të Republikës së Kosovës që nga pas lufta e deri më sot, duke vënë theks të veçantë në rritjen e qëndrueshme të investimeve të huaja, në veçanti ato gjermane, marrë parasysh që investitori më i madh në Kosovë ka qenë dhe vazhdon të jetë Republika Federale e Gjermanisë. Përveç



temave ekonomike, deputetët gjermanë u njoftuan edhe rreth temave aktuale politike, sigurisë

së vendit si dhe mundësive për zhvillim dhe bashkëpunim të mëtejshëm jo vetëm në

Kosovë, por edhe në rajon”, thuhet në njoftimin e OEGJK-ut. Referuar njoftimit, delegacioni u

interesua kryesisht për sektorin e energjisë në Kosovë, ku u njoftua për Strategjinë e Energjisë 2030, zhvillimet e fundit në këtë sektor, por edhe për potencialin që ofron Kosova për tërheqje të investimeve të huaja, në veçanti investimet në energji solare dhe me erë.

Nga Procesi i Berlinit, perspektiva evropiane për anëtarësim të Kosovës në Bashkimin Evropian, reformat në sektorin e energjisë, deri tek arsimit dhe aftësimi profesional, ishin pikat kyçe të takimit të djeshëm. “Kur të tjerët janë mirë, edhe Bavaria është mirë”, tha deputeti i CSU, Karl Freller. Ai theksoi rëndësinë e zgjerimit të bashkëpunimit të Kosovës dhe Gjermanisë, në veçanti me rajonin e Bavarisë. Më pas OEGJK e ka shoqëruar delegacionin gjerman në kompani të ndryshme.

## Mbi 5 000 konsumatorë kanë përditësuar të dhënat në KESCO

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Ka disa javë që KESCO ka filluar fushatën e përditësimit të të dhënave të konsumatorëve. Deri tash mbi pesë mijë konsumatorë e kanë përfunduar këtë proces. Në zyrat e përkujdesjes ndaj konsumatorëve që KESCO ka anekënd Kosovës, çdo ditë janë duke ardhur për përditësim mbi 500 konsumatorë. Kjo bën që procesi të shkojë me ritme të kënaqshme, duke e përmbushur secili një obligim ligjor që rregullon marrëdhëniet kompani-konsumator, sikurse ndikon edhe në mirëfunksionimin e sektorit elektroenergetik.

Përditësimi i të dhënave, pos që është kusht ligjor, ka edhe përfitime të shumanshme. Konsumatorët që e kryejnë këtë proces sigurohen që faturën e energjisë elektrike do ta pranojnë pikërisht në objektin ku jetojnë.

Qasjen në informata të shpejta rreth furnizimit me energji elektrike

e kanë të garantuar, mund të paraqesin lehtësisht kërkesa apo ankesa dhe askush nuk mund t'u le asnjë borxh.

Rëndësia e përditësimit të të dhënave rritet shumë sidomos te rastet kur konsumatorët kanë njehsor, por nuk është në rastin e tyre, pastaj kanë ndryshuar vendbanim, kanë qiramarrës, e kanë ndryshuar numrin e telefonit apo e kanë një numër tjetër aty dhe e kanë blerë apo shitur shtëpinë pas përditësimit të fundit të të dhënave. Konsumatorët hyjnë në limite kohore vetëm kur i njofton KESCO përmes kontaktimit të drejtpërdrejtë. Në momentin që kompania i kontakton ata, atëherë konsumatorët duhet ta bëjnë përditësimin brenda dy javësh. Pas kësaj periudhe mund të jenë subjekt i shqyqjes nga rrjeti elektrik. Pra, vetëm konsumatorët që kontaktohen janë subjekt i shqyqjes.



## Nurboja: BQK-ja realizoi 27 milionë euro profit gjatë vitit 2023

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës, Bashkim Nurboja, ka njoftuar se BQK-ja ka

miratuar raportin për vitin 2023. Nurboja në “Facebook” ka bërë me dije se është shumë i kënaqur me performancën e

Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2023. “Miratohet raporti vjetor 2023. Shumë i kënaqur me performancën e BQK-së.

Profiti mbi 27 milionë euro, nga të cilat mbi 10 milionë euro i ndahen buxhetit të shtetit”, ka shkruar Nurboja.



# Pse (kryesisht) je superior ndaj miut?!

*Për librin Rat City të Jon Adamsit dhe Edmund Ramsdenit – një histori e shkëlqyeshme shkencore që na flet për ndikimin e keq që pati studimi pionier i John B Calhounit*



Nga: The Daily  
TELEGRAPH

Është një shaka e vazhdueshme mes shkencëtarëve se shumica e titujve rreth përparimeve shëndetësore duhet të kenë prapshitesën me fjalët “te miushët”: “Vitamina D rregullon imunitetin ndaj kancerit”? Sigurisht – te miushët. Sepse, ka shumë ndërlidhje mes miushit dhe njeriut, dhe jo vetëm në mjekësi, por edhe në psikologji dhe në sociologji – siç dëshmon rrëfimi magjepsës i Jon Adamsit dhe Edmund Ramsdenit.

Miushët dhe vëllezërit e tyre më inteligjentë, miu i gjirizit, janë përdorur prej kohësh si përfaqësues të njerëzve në laborator. Psikologu famëkeq BF Skinner shpiku “dhomën e kondicionimit operant”, ose atë që u bë e njohur (për inatin e tij) si “kutia e Skinnerit”: në të, një mi ose një pëllumb shtypte një levë për të marrë një sasi ushqimi, ose u inkurajua të lëvizte nga njëra anë e kutisë në tjetrën teksa muret ngroheshin. Nga rrëfimet e Skinnerit për eksperimentet e tilla, fituam konceptin e “përforcimit

pozitiv” të sjelljes.

Heroi i Qytetit të minjve të gjirizit [Rat City], John B Calhoun, ishte shkencëtar amerikan i cili mendonte se eksperimente e tilla ishin shumë të kufizuara për të na treguar më shumë për realitetin. Në vend të kësaj, nga viti 1947 e deri në vitin 1982 ai e ndërtoi një seri gjithnjë e më të komplikuar të komplekseve të banimit prej druri (të cilat më vonë i quajti “universe”), për miushët dhe për minjtë e gjirizit, të cilat përmbanin dhjetëra apo edhe qindra kafshë, ndërsa regjistroi ngritjen dhe rënien e gjithë shoqërisë së brejtësve. Rezultatet e tij u bënë të famshme dhe kontribuuan në panikun e mesit të shekullit rreth mbipopullimit global dhe degradimit social.

Pse minjtë? Shumë prej tyre janë në vende të gabuara, kështu që ishin “dëmtues” urbanë. Nuk bëri punë helmimi i një blloku të tërë të qytetit që kishte minj gjirizi, sepse gjithçka që bëri kjo ishte inkurajimi i kolonive fqinje për të zgjeruar territorin për të mbushur boshllëkun. Shumë njerëz supozuan se prevalenca e minjve në rrethet e varfra dëshmoi se njerëzit e varfër ishin të pisët, por siç treguan Calhoun dhe të tjerët,

njerëzit i kishin minjtë problem sepse kishin probleme me cilësinë e strehimit. Prishja e lagjeve të varfra dhe kalimi i të varfërve në ndërtesat shumëkatëshe prej betoni, nuk ua bëri jetën më të mirë.

Në të vërtetë, puna e Calhounit dukej se dëshmonte se pse premtimi i rrokaqiejve ishte i rremë. Teksa rritej popullsia e qyteteve të tij të minjve të gjirizit, kafshët u bënë më me stres. E quajmë këtë “mbipopullim”, por siç zbuloi Calhoun, arsyeja e shqetësimit të minjve nuk ishte mungesa e hapësirës fizike për secilën kafshë, por kontakti i vazhdueshëm i padëshiruar shoqëror. Individët nuk mund të formonin më grupe të vogla, por vuanin nga rritja e vazhdueshme e adrenalinës nga gjithë të tjerët gjatë gjithë kohës.

Pasi kolonitë e minjve kishin arritur këtë prag të mbipopullimit, struktura shoqërore tërësisht u shpërbë. Shpërthyen luftimet e egra dhe nënat e ndalën kujdesin për të vegjlit. Disa minj thjesht u larguan plotësisht nga kontaktet sociale dhe seksuale dhe e kaluan gjithë kohën duke u kujdesur për veten. U quajtën “Të bukurit”, por nuk lanë pasardhës. Më në fund, e gjithë

kolonia ngordhi.

Edhe te njerëzit (ose kështu menduan njerëzit), zgjedhja midis izolimit të plotë ose takimeve të rastësishme stresuese – si në blloqet e reja të rrokaqiejve të cilët eliminuan fqinjësinë në shkallë të vogël të shtëpive me tarraca – do të krijonte gjithashtu stres kronik. Psikiatri anglez Humphry Osmond ridizajnoi me sukses disa spitale mendore amerikane, larg modelit mbizotërues të hapësirave të mëdha komunale dhe me dhoma të vogla, duke krijuar shumëllojshmëri të qosheve të rehatshme të ndërmjetme dhe kështu pacientë shumë më të lumtur.



Megjithatë, një pasojë më e keqe e punës së Calhounit ishte përdorën ato për të përhapur një mesazh politik pseudoshkencor. I tillë ishte Desmond Morris i cili shpejt e shpejt për vetëm disa javë, më 1966 e ka shkruar librin Majmuni cullak [The Naked Ape]. “Tashmë e dimë se nëse popullsia jonë vazhdon të rritet me ritmin e tmerrshëm aktual”, shkroi Morris, “në mënyrë dramatike do të rritet agresiviteti i pakontrollueshëm. Kjo më në fund është vërtetuar me eksperimentet laboratorike”. Këtu,

Morris nuk shtoi – siç duhej të kishte bërë – frazën e famshme: “te miushët”.

Adamsi dhe Ramsdeni tregojnë se si pohimet e tilla tepër të sigurta kanë luajtur rol në ankthin mbi krimin dhe trazirat civile në Amerikën e viteve 1960, duke i paraqitur ato fenomene thjesht si “refleks biologjik ndaj numrit në rritje të popullsisë”, dhe kështu duke e zhvendosur fajin “nga politika bashkëkohore te historia evolucionare”. Në fund të fundit, nëse konflikti i tillë përcaktohet nga natyrat tona shtazore, pse përpiqemi ta bëjmë jetën më të mirë për njerëzit? Pse të mos ketë më pak njerëz? Kështu pëshpëriti edhe një herë kureshtari eugenik. Siç tashmë e dimë, bomba e popullsisë nuk shpërtheu në mënyrën e parashikuar apokaliptike. Dhe, nëse sot ndihemi si minj ose minj të stresuar, kjo nuk është sepse jemi shumë prej nesh, por sepse e kemi harruar mësimin e vërtetë të punës së Calhounit: se rëndësi ka dizajni njerëzor i banesave dhe hapësirave të tjera. Për shembull, u falënderova, në fund të këtij libri të shkëlqyer, pse për të nuk shkrova nga hapësira e madhe e ndarë me paravane.

*/Përkthimi: Telegrafi.com*





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Duka: Të gjithë jemi krenarë me Kombëtaren, tifozët meritojnë notën 10

TIRANË, 27 QERSHOR - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, ishte i ftuar në emisionin "Kampionët" në TV Klan. Kreu i qeverisë së futbollit shqiptar komentoj paraqitjen e Kombëtares në Kampionatin Evropian "Gjermani 2024" duke vlerësuar ekipin dhe stafin teknik, ndërsa shtoi se mund të bënim më mirë për sa i përket rezultatit. Presidenti Duka foli për disa tema të ndryshme dhe theksoi se ekipi duhet falënderuar për rrugëtimin deri në Kampionatin Evropian, ndërsa shtoi se tifozët shqiptarë në Gjermani ishte për notën "10 me yll". "Ka gjëra për të cilat duhet të jemi krenarë. Ekipi duhet falënderuar që na çoi atje, jo vetëm ata që ishin në Evropian. Paraqitja ishte e mirë, rezultati nuk ishte i mirë. Rezultati do të ishte i mirë nëse do ta kalonim grupin. Po të ishim pak më inteligjentë do ta kishim kaluar grupin. Po të ishim pak më të përgatitur psikologjikisht. Ndeshjen e parë me Italinë, pasi shënuam, ndoshta ramë në emocion. Goli që në futboll duhet të të llojë dhe të shkosh përpara, na futi nën presion. Në atë ndeshje mbase duhet të ishim më të përgatitur psikologjikisht. Por në total jam i kënaqur", u shpreh Duka.

Në lidhje me kualifikimin historik të Gjeorgjisë për rrugëtimin e mëtejshëm në "Euro 2024", Duka u shprehur i kënaqur dhe tha se skuadra e Gjeorgjisë ka pasur një performancë fantastike. "Gjeorgjia ka skuadër të mirë dhe unë prisja që do të bënte diçka të mirë sot dhe e bëri. Kam parë rreth 70 minuta, sepse më duhej të udhëtoja për në emision. Vërtet ajo që më kënaqi te Gjeorgjia ishte grinta dhe dëshira e forca me të cilën luajti dhe e meritoi rezultatit. Më pëlqeu që Gjeorgjia u kualifikua, sepse ka hapa pozitive prej vitësh. Erdhi me vështirësi në kampionat dhe e meritoi. Të fitosh kundër Portugalisë nuk është e lehtë. Edhe ndeshjet e tjera i ka bërë të mira. Performancë fantastike", ka shtuar Duka. Për sa i përket Evropianit të Shqipërisë, Duka tha se ka qenë shumë emocionues dhe shtoi se duhet përvoja, që të jetë më e lehtë menaxhimi i emocioneve edhe për lojtarët. "Tani nga 24 skuadra, 8 do të eliminohen. Për mua të 24-t janë të nivelit të lartë, përderisa bëhen pjesë e Evropianit. Fakti që Gjeorgjia kalon dhe Ukraina nuk kalon me 4 pikë tregon se dallimet nuk janë shumë të mëdha. Qoftë edhe ne, mbase me më shumë zgjuarsi, apo me më pak emocion mund dhe duhet ta kishim kaluar grupin edhe pse ishim në 'Grupin e Vdekjes' siç u etiketua. Nuk do të thotë ndonjë gjë, sepse ato skuadra që ishin në grup me ne u eliminuan janë më pak të forta, apo më të dobëta. Kam përjetuar emocione shkatërruese. Sidomos ndeshjen me Kroacinë kam menduar se nuk do të shkoj deri në minutën e 90, kështu që imagjino ato të tjerët që kanë qenë në fushë. Më shumë emocione se tek ajo ndeshje nuk kam ndier asnjëherë në jetën time sepse ishim 1-0, shkonim pranë golit dhe duke e ditur atë teorinë e futbollit që nëse nuk shënon do të pësosh, ajo ma shtonte më shumë ankthin, emocionin dhe faktikisht ndodhi që ata shënuan dy herë. Pastaj ekipi tregoi shumë karakter që e barazoi dhe mund ta përmbyste atë rezultat. Emocioni kryesor ka qenë në atë ndeshje, por Evropiani ka shumë emocion, prandaj thuhet që duhet



përvojë. Pikërisht kjo është përvoja që t'i menaxhosh emocionet", theksoi kreu i qeverisë së futbollit shqiptar. Presidenti Duka ka thënë se në ekipin kombëtar duhet të injektohet besimi që në çdo ndeshje, pavarësisht prej kundërshtarit, ekipi duhet të futet në fushë vetëm për fitore. "Në disa intervista për mediet italiane, kam thënë që fiton Shqipëria ndaj Italisë dhe të dyja kalojmë grupin. Nuk kam menduar lehtësisht se do të kalojmë grupin. Shumë mirë që keni besuar, sepse keni parë ndeshjen me emocion dhe pritshmëri. Jemi munduar ta injektujmë këtë besim te skuadra ndaj Spanjës. Nuk e injektuam dot, siç bëri Gjeorgjia. Ne duhet ta besonim fitoren me Spanjën duke marrë parasysh që ajo e kishte realizuar objektivin. Ekipi ynë nuk arriti ta besojë pavarësisht se u mundua pa fund dhe luajti mirë, krijoi shanset e veta, por nuk i shfrytëzoi. Tifozët shqiptarë në Gjermani për mua kanë qenë 10 me yll, sepse jo vetëm se kishte në numër të paimagjinueshëm për një vend kaq të vogël sa Shqipëria, por në të gjitha këndvështrimet. Për dekorin që kanë krijuar, për atmosferën në të tre qytetet. Kanë qenë vërtet fantastikë. E bukur e kampionatit që njerëzit në përgjithësi e vlerësojnë me nota pozitive është që ne ishim në garë deri në momentin e fundit. Mund të ishte edhe ndryshe që të shkonim në ndeshjen e fundit për turizëm dhe nuk do të ishte interesante. Ti mendon se kur të shkojmë në Botëror do të themi që do të pësojmë 5 gola? Kur të shkojmë në Botëror, ne prapë do të themi që luajmë për fitore. Ky është objektivi. Të gjithë ata që janë rreth kombëtares duhet ta injektujmë besimin për fitore. I pari presidenti, i dyti trajneri dhe të gjithë ata që janë rreth kombëtares, deri te punëtori i fushës, duhet ta injektujmë të njëjtën gjë: besimin për fitore. Unë i kam dëgjuar këto përralla gjithmonë. I kam dëgjuar edhe kur thosha që do të shkojmë në Evropian, por ne u kualifikuam. Të gjithë duhet të besojnë te fitorja, jo vetëm presidenti. Nuk mund të shkojmë në asnjë garë dhe kompeticion duke thënë që do të humbas. Këtë e vlerëson publiku. Futboli nuk ka fund. Mund të shkosh në finale, humb dhe thua është dështim. Unë këtë e quaj një histori super të suksesit të futbollit, të publikut, të opinionit dhe të gjithëve. Nëse hyn në një betejë për ta humbur kurrë nuk do ta fitosh. Në çdo ndeshje e përsërita që do ta fitojmë. Qëndrimi im para Evropianit: duhet të jemi krenarë dhe jemi krenarë që jemi në Evropian. Ne nuk kemi çfarë të humbim. Kam thënë që do të

fitojmë ndaj Italisë dhe do ta them sërisht", u shpreh Duka, i cili vlerësoi edhe lojtarët e ekipit kombëtar. "Kjo loja jonë është kaq shumë e bukur edhe për faktin që u jep të drejtë të gjithëve. Ti ke të drejtë, ai gazetari që kishte bërë kronikën ka të drejtë, çdo njeri ka të drejtë. Sylvinho si trajneri i Shqipërisë ka fat, sepse ka vetëm 10 milionë shqiptarë që mendojnë se janë trajnerë. Ai i Brazilit ose një tjetër është më pa fat. Broja? Ai është një futbollist me cilësi të jashtëzakonshme, me kualitet shumë të mirë, sidomos për ekipin tonë, se nuk them që është futbollisti më i mirë në Evropë apo në Botë, që padyshim do ta ndihmojë më shumë ekipin. Dimë që ka pasur një dëmtim të rëndë, është rikthyer dhe kaq minuta ka menduar trajneri. Nëse do ta kthej ndeshjen e Spanjës të filmuar mendoj se do ta kishte ndihmuar po të kishte minuta më shumë, por nëse do të isha para ndeshjes së Spanjës duke parë se sa mirë luajti Manaj kundër Kroacisë, mbase do të thosha që duhej të luajë Manaj. Arbër Hoxha? Ai e ka ndihmuar shumë ekipin në të gjitha minutat që ka luajtur dhe asnjë nuk mund ta mendojë. Në ato minuta që ka luajtur ka dhënë aq shumë. Nëse do të luante më shumë minuta a do të ishte aq mirë, apo jo. Këtë nuk e di. Duhet të ndodhte. Në fakt, aq minuta sa ka luajtur ka luajtur shkëlqyer", ka shtuar Duka, i cili shtoi se kontrata me trajnerin Silvinjo ka përfunduar, por i është ofruar propozimi i ri. "Kontrata me trajnerin ka mbaruar pas Evropianit. Ne i kemi propozuar rinovimin që në janar. Besoj se tani së shpejti do ta finalizojmë. Ne kemi pasur biseda. Secili njeri mendon për veten e tij. Nëse i vjen një shifër marramendëse, edhe mund të shkojë. Kontrata është e përfunduar kur e firmos në letër. Gjasat që ta rinovojë, sigurisht janë mbi 50%. Ne bëjmë aq sa mundemi për ta mbajtur, nuk mund të bëjmë më shumë se kaq. Në karrigen time duhet t'i mendosh të gjitha gjërat. Dëshira për ta pasur është aq e madhe, sa ia kemi bërë që në janar ofertën për rinovim. Pas kthimit në Shqipëri bëmë një festë të vogël me stafin. Sot Silvinjo iku të pushojë dhe do të rikthehet për të vendosur për të ardhmen. Do të vendosim para se të përfundojë Evropiani. Do të shkojmë ta shikojmë finalen bashkë. Nëse del një klub i La Ligës dhe i jep 5 milionë euro, e ka hallall. Mançini la Italinë për një ofertë të majme", ka shtuar Duka. Kreu i qeverisë shqiptare të futbollit zgjodhi Silvinjon si trajnerin më të mirë që ka pasur kombëtarja dhe pas tij De Biasin. "Nuk do t'i shmangem asnjë pyetjeje. Na erdhi për mirë goli i shpejtë ndaj Italisë, se thyem një rekord. Ne mund të kishim menduar shumë gjëra, por ta bënim golin për 23 sekonda ndaj Italisë nuk e menduam kurrë. Silvinjos i vë notë kaluese, pozitive. Nuk ka kurrë 10 në futboll. I jap 7. Të parin zgjedh Silvinjon. Ka krijuar atmosferë pozitive në një kohë shumë të shkurtër. I dyti është De Biasi, sepse kemi shkuar në Evropian me të për herë të parë. Nga pikëpamja taktike, kam respekt të madh për Oto Baric. Zhgënjimi më i madh nga të gjithë trajnerët është Panuçi, pas tij Dosena. Goli më i bukur i shënuar nga lojtarët e Kombëtares në Evropian është i Bajramit. Lojtari më i mirë i Evropianit nga ekipi shqiptar për mua ishte Asllani".

### SHKURT

#### Berisha mund t'i bashkohet Sampdorias

Etrit Berisha nuk u aktivizua asnjë minutë në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Ai tash është në kërkim të një skuadre të re. Mediet italiane raportojnë se Sampdoria mund të jetë e ardhmja e Berishës, pasi drejtori i ri sportiv i Sampdorias, Pietro Acardi, e njeh mirë Berishën dhe synon transferimin e tij. Ky do të ishte një transferim me koston zero, duke qenë se kontrata e portierit kuqezi me Empolin skadon më 30 qershor. Një portier me përvojë dhe një transferim me koston zero, duke përmbyshur kërkesat e klubit. Për momentin oferta ndodhet në tryezën e Federico Pastorellos, agentit të portierit kuqezi, por pritet që situata të zgjidhet sa më shpejt, me Berishën që mund të jetë nën urdhrat e trajnerit të Sampdorias, Andea Pirlo.

#### Ronaldo me rekord negativ në 'Euro 2024'

Sa herë përmenden rekordet në futboll, në mendje bie edhe emri i Cristiano Ronaldos, sidomos kur fjala është për kampionate evropiane, pasi aty Ronaldo është kryefjala, duke pasur më së shumti gola dhe asistime në gjithë historinë e "Euro"-s. Mirëpo, kësaj here Cristiano Ronaldo ka "thyer" një rekord negativ. Për herë të parë në karrierën e tij, Ronaldo ka dështuar të shënojë në fazë të grupeve të një turneu madhor. Ronaldo nuk arriti ta gjejë rrugën e rrjetës në tri ndeshjet ndaj Çekisë, Turqisë e Gjeorgjisë. Që nga debutimi i tij në "Euro 2024", Ronaldo ka shënuar gol në fazën e grupeve të çdo turneu madhor tjetër, duke përfshirë këtu edhe Kupën e Botës.

#### De Bruyne: S'jemi favoritë ndaj Francës, por duam ta fitojmë 'Euro 2024'

Mesfushori Kevin de Bruyne ka thënë se Belgjika s'është favorite ndaj Francës, por duhet ta eliminojë për ta fituar tërë Kampionatin Evropian "Euro 2024". Belgët kishin mjaft vështirësi në grupin e tyre, duke vazhduar si pozitë e dytë me katër pikë prapa Rumania. Belgjika bëri paraqitje të zbehtë edhe në përbaljen e fundit andaj edhe u kritikua nga tifozët, ndërsa në 1/8 e finales do të përballet me njërin nga favoritët, Francën. "Nuk jemi favoritë kundër Francës, por duhet t'i mposhtim të gjithë për ta fituar Euro 2024. Kemi qenë edhe në krahun e djathtë të fotografisë dhe jemi eliminuar, prandaj nuk vlen shumë", ka deklaruar De Bruyne. Ndërkohë, fituesi i kësaj përbaljeje do të takohet me fituesin e ndeshjes në mes të Portugalisë dhe Sllovenisë.



## Renditja e golashënuesve në 'Euro 2024', asnjë gjurmë e yjeve të sulmit

DORTMUND, 27 QERSHOR - Protagonistë të pritshëm, mungesa të pajustificuara. Faza e grupeve të "Euro 2024" përfundoi të mërkurën, por nuk ka asnjë shenjë nga kampionët e mëdhenj. Nga Harry Kane te Kylian Mbappe (nga një gol

secili), deri te Romelu Lukaku dhe Cristiano Ronaldo (ende pa gola), emrat më të mëdhenj kanë dështuar deri tani. Pritet një reagim i fortë i tyre në fazën me eliminim direkt. Renditja e golashënuesve të këtij Evropiani, deri tani, është e

qartë dhe asnjëherë më parë nuk është vënë re mungesa e më të mirëve si këtë edicion. Mes yjeve shkëlqen vetëm Jamal Musiala, i cili ka shënuar dy gola për Gjermaninë. Në epërsi, megjithatë, është Georges Mikautadze i Metzit, i cili

shënoi në të tria ndeshjet e grupit për Gjeorgjinë. Lista e golashënuesve: Mikautadze (Gjeorgji) 3, Fullkrug (Gjermani) 2, Musiala (Gjermani) 2, Gakpo (Holandë) 2, Marin (Rumani) 2, Schranz (Sllovakia) 2.



## Çereku i tretë vendimtar në humbjen e Kosovës

PRISHTINË, 27 JANAR - Në Prishtinë po vazhdon FIBA Kampionati Evropian për Shtetet e Vogla. Kosova në ndeshjen e dytë ka pësuar nga Qipro me rezultat 48:57. Periudha e parë ishte e baraspeshuar, ku qipriotet nuk shënuan në pesë minutat e para, por kjo pjesë përfundoi 13:11. Megjithatë, në periodën e dytë, mysafiret ishin më të mira, duke shkuar në pushim me rezultat 26:37. Qipro vazhdoi me lojë të mirë në çerekun e tretë, ku u bë dallimi më i madh dhe vendimtar, pasi kishin epërsi deri në 21 pikë, kurse shifrat pas 30 minutash ishin 38:59. Në dhjetë minutat e fundit nuk kishte ndonjë dallim të madh dhe Qipro triumfoi 48:67. Aulona Muhadri kishte 17 pikë e 13 kërcime te Kosova, derisa Enisa Kamerolli shtoi 16 pikë. Kjo ishte humbja e dytë për Kosovën dhe fitorja e dytë për Qipron. Në ndeshjen tjetër



të Grupit B, Malta mundi Gjeorgjinë me shifrat 88:68. Edhe Malta u kualifikua në gjysmëfinale. Në ndeshjet e Grupit A, Norvegjia pa problem mundi Andorrën 72:39, kurse Shqipëria fitoi ndaj Armenisë

70:64. Norvegjia dhe Shqipëria u kualifikuan në gjysmëfinale. Ndeshjet do të vazhdojnë edhe sot, që është dita e fundit e grupeve. Në fundjavë zhvillohen gjysmëfinalët, finalja dhe për pozitat 5-8.

## Drejtori i Ferrarit: Në Austri dua fitore, jo ankesa në pistë

VJENË, 27 QERSHOR - Pas dy të dielave anonime, Ferrari dëshiron të buzëqeshë sërish. Këtë fundjavë do të garohet në Austri, një pistë që normalisht i përshtatet "kokëkuqes", me Charles Leclerc që ka dalë fitues këtu në vitin 2022 dhe Ferrari ka ngjitur gjithnjë një pilot në podium. Gara e fundit në Spanjë pati disa përplasje mes pilotëve të makinës italiane, ndaj drejtori sportiv Frederic Vasseur ka kërkuar qetësi. "Si ekip, duke përfshirë edhe pilotët, duhet të bëjmë një hap për t'u siguruar që të mos lëmë asnjë mundësi në rrugë. Si në provat zyrtare, garën sprint apo në garën normale", ka thënë Vasseur. "Në Austri dua të shoh një ndryshim të ritmit dhe jo ankesa në pistë. Përditësimet e paraqitura në garën e fundit funksionuan siç pritej, por ne pamë se si rivalët tanë nuk rrinë duarkryq dhe se si për momentin janë katër skuadra në një hapësirë më pak se tri të dhjetat", ka shtuar



më tej francezi. "Tani do të shkojmë në Austri, një pistë që mund të mbulohet në pak më shumë se një minutë, në të cilën këto boshllëqe tashmë të ngushta

do të ngushtohen edhe më shumë. Duhet të përqendrohemi shumë te vetja, sepse në Spielberg çdo detaj do ta bëjë dallimin", ka deklaruar Vasseur.

### SHKURT

#### Kroacia dështoi në 'Euro 2024', Daliqi do të vazhdojë të jetë trajner

Zlatko Daliq do të mbetet trajner i Kombëtares së Kroacisë edhe pse kjo kombëtare ka pasur paraqitje zhgënjyese në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Edhe pse pritej që Daliq të largohej pasi Kroacia e mbylli në vendin e tretë në Grupin B me vetëm dy pikë, një gjë e tillë nuk do të ndodhë. Kështu ka thënë presidenti i Federatës së Futbollit të Kroacisë, Marijan Kustiq, që ka konfirmuar se Daliq do të mbetet në detyrën e selektorit. "Ai është selektor dhe do të mbetet përzgjedhës i kombëtares kroate të futbollit. Ne biseduam dhe zgjatëm duart", ka thënë Kustiq për "Nova TV".

#### Kvaratskhelia: Mund të përballemi me të gjithë

Ylli i madh i Gjeorgjisë, Kvicha Kvaratskhelia, ka folur pas fitores 2-0 ndaj Portugalisë në Gelsenkirchen që e dërgoi Gjeorgjinë në mënyrë sensacionale në 16-tën e fundit të "Euro 2024" kundër Spanjës. "Jam shumë i lumtur sot sepse ia dolëm. Portugalia është një ekip i madh, por ne fituam. Unë u thashë shokëve të mi se jemi një ekip shumë i mirë dhe mund të luftojmë të gjithë", ka thënë Kvaratskhelia. Ndeshjet e para të 1/16 të finales fillojnë të shtunën me takimin në mes të Zvicrës dhe Italisë.

#### Sancho kundër rikthimit në United

Jadon Sancho u huazua nga Manchester Unitedi në Borussia Dortmund dhe me këtë skuadër arriti deri në finale të Ligës së Kampionëve, ku pësoi humbje nga Real Madridi. Sulmuesi anglez shpreson që Dortmundi të arrijë marrëveshje me "Djajtë e Kuq" për transferimin e tij të përhershëm në "Signal Iduna Park", ku po kalon një moment shumë të mirë. Ndërkaq, kujtojmë se që prej rikthimit të tij në Bundesliga, Sancho është kthyer në një protagonist të vërtetë, te skuadra e teknikut Edin Terziq, ku në 21 përballjet e zhvilluara që prej janarit ka arritur të regjistrojë tre gola si dhe tri asistime.

#### Southgate: Tifozët na kritikojnë edhe pse jemi kualifikuar

Trajneri i Anglisë, Gareth Southgate, është ankuar për atmosferën e krijuar rreth kombëtares, sipas tij, të pazakontë, pas barazimit 0-0 me Slloveninë. Një rezultat që i kualifikoi të dyja kombëtares në fazën e 1/8-ave të "Euro 2024". Ndërkohë që lojtarët sllovenë festuan momentin historik me mbështetësit e tyre, trajneri dhe lojtarët anglezë u pritën me fishkëllima dhe hedhje të gotave plot birra kur iu afruan pjesës së stadiumit të Kolnit të rezervuar për tifozët e tyre. Vetë Southgate u vu në shënjestër të tifozëve, skena që kanë lënduar pa masë trajnerin e kombëtares së "Tre Luanëve". "Nuk kam parë asnjë skuadër tjetër të kualifikohet dhe të ketë një reagim të tillë. Unë jam shumë krenar për lojtarët, për mënyrën se si e ruajtën qetësinë në ndeshje. Jemi në një turne ku ka shumë sfida dhe konkurrencë. Gjithsesi, nuk e kuptoj këtë atmosferë aspak të këndshme ku na duhet të punojmë", ka thënë Southgate.

## Oblak: Në Gjermani nuk jemi për turizëm

Sllovenia siguroi kualifikimin për në fazën e 1/8-ave këtë të martë, duke shkruar edhe historinë, pasi kjo kombëtare për herë të parë kaloi fazën e grupeve. Pas barazimit 0-0 me Anglinë, sfida në

të cilën Sllovenia siguroi pikën e tretë në këtë Evropianin, Jan Oblak foli për të ardhmen duke theksuar se nuk janë thjesht për turizëm në Gjermani. "Përballë Anglisë as nuk e di se çfarë ndodhi në minutat e

fundit pasi po prisja vetëm sinjalizimin dhe të festonim. Këto ndjesi janë vërtet fenomenale, ka pasur pak vuajtje gjatë ndeshjes, vërtet nuk ishte e lehtë, por pastaj kalon gjithçka. Ne jemi të lumtur,

krenarë dhe të kënaqur që erdhëm në Gjermani dhe bëmë histori, por dua të theksoj se nuk jemi për turizëm këtu dhe duam të vazhdojmë përpara. Ndaj Anglisë e gjithë skuadra ishte

kompakte, bëmë një ndeshje të madhe, por besoj se kemi treguar shumë personalitet edhe ndaj Danimarkës dhe Serbisë, dy kundërshtarë jo të lehta", ka thënë Oblak.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

#### NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 27.05.2024, për vendin e punës:

**I. Pozita:** Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit

**Numri i referencës:** UNP/ZKA/05-07/24

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 1002 të datës 27.06.2024

Prishtinë, 27.06.2024

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

#### OBAVEŠTENJE O PONIŠTENJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije objavljuje poništenje konkursa raspisanog u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 27.05.2024. godine, za radno mesto:

**I. Pozicija:** Rukovodilac Jedinice za nabavku

**Referentni broj:** UNP/ZKA/05-07/24

Konkurs se poništava na osnovu Odluke br. 1002 od 27.06.2024.

Priština, 27.06.2024

Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Faza Gjuraj nga Xerxe KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u "Hamëz Thaqi" Xërxe KK Gjakovë.

- Genti Nushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shme "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Dafina Cana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimanzit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908  
0.5L





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

